

PËLLUMB XHUFI**BENDA E ARBRIT NË MESJETËN E VONË**

Në fund të shek. XII, në mënyrë të qartë, por në fakt qysh në shek. XI, në burimet bizantine dhe në ato papale e sllave, përmendet vazhdimisht krahina e Arbrit ("Αλβανον, Albanum, Рабънь")¹. Këtu u krijua i pari formacion shtetëror mesjetar shqiptar, Principata e Arbrit². Për vetë pozicionin gjeografik, afër Durrësit e përgjatë rrugës Egnatia, Arbri ka qenë në qendër të historisë mesjetare jo vetëm shqiptare, por edhe të asaj adriatiko-ballkanike, dhe jo më kot, balkanologë e albanologë të shquar, e kanë pagëzuar Arbrin si "bërthamën" e Shqipërisë Mesjetare³.

Për të njohur kufijtë e krahinës së Arbrit në Mesjetë na ndihmojnë përshkrimet historike, të Ana Komnenës e sidomos të Gjergj Akropolitit: sipas këtij të fundit, Arbri përfshinte gjithë zonën kodrinore e malore midis rrjedhjeve të lumit Mat, në Veri, Shkumbin, në Jug, e midis rrjedhave të poshtme të tyre, në Perëndim, e vijës Dibër-Ohër, në Lindje⁴. Kjo shtrirje gjeografike u njëhua me Principatën e Arbrit, në shek. XII-XIII, me zotërimin (*kontenë*) e Topiajve, në shek. XIV, dhe me

¹ Ludvig Thalloczy - C. Jireček, "Zwei Urkunden aus Nordalbanien", në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*, I. Band, München und Leipzig: 1916, f. 27.

² A. Soloviev, "Eine Urkunde des Panhypersebastos Demetrios, megas archon von Albanien", në: *Byzantinische Zeitschrift*, 34 (1934), f. 304 vj.

³ Milan Šufflay, *Srbi i Arbanasi*, Beograd: 1925, f. 3-5, 34-35; *Realenzyklopädie*, 5. Band, f. 1988-1993; Alain Ducellier, "Nouvel essai de la mise au point sur l'apparition du peuple albanais dans les sources Byzantines", në: *Studia Albanica*, nr. 2, 1972, f. 301; M. Angold, *A Byzantine Government in Exile*, Oxford Univ. Press, 1975, f. 280; G. Prinzig, "Studien zur Provinz- und Zentralverwaltung im Machtbereich der epirotischen Herrscher Michael I und Theodoros Dukas", në: *Epeirotika Chronika*, 25 (1983), f. 57.

⁴ An. Comnena, *Alexias*, bot. Bonn, vëll. II, 1878, f. 199; Georg. Acropolites, *Chronike Syngraphe*, Bonn: 1837, f. 28, 98, 149; L. Thalloczy - C. Jireček, "Zwei Urkunden ...", f. 127; A. Ducellier, "L'Arbanon et les Albanais au XI siècle", në: *Travaux et Mémoires*, III, Paris, 1968, f. 353-356.

bërthamën e qëndrueshme të shtetit të Skënderbeut, në shek. XV⁵. Një shekull e gjysëm pas vdekjes së Skënderbeut, në vitin 1621, një banor i shquar i këtyre viseve, Pjetër Budi nga Gurabardhi, na kumton se patriotët e tij i quanin territoret e Arbrit të dikurshëm si vendet e Skënderbeut, ku sipas tij përfshiheshin krahinat e Matit, Bendës, Kurbinin, Tamadhesë e të Çermenikës, që ndodhen në malësitë prapa Krujës e Elbasanit⁶.

Ky njoftim i Pjetër Budit i vitit 1621 është më i shkoquri, që na sqaron, duke i cituar me emër, krahinat që përfshiheshin në përbërje të Arbrit mesjetar. Sigurisht, nuk citohet aty ndonjë krahinë, si Dibra, që e mbyllte Arbrin në krahun lindor. Gjithashtu, gjejmë të cituar Çermenikën, që e përmend që në vitin 1510, Gjon Muzaka në kronikën e tij të njohur, si zotërim të Gjergj Arianitit⁷. Por nuk zihet në gojë krahina fqinje me të, Martaneshi, dhe heshtja për këtë krahinë vazhdon deri në shek. XVII, nëse përjashtojmë Defterin e Sanxhakut të Dibrës të vitit 1467, ku emri Martanesh shfaqet, por, për të treguar thjesht një fshat që mbante këtë emër⁸.

Megjithatë, bashkë me Kurbinin, Bendën e Çermenikën, Pjetër Budi që ishte një njohës i shkëlqyer i kësaj treve, citon vendin e Tamadhesë. Tamadhenë (*Tamadia*) e përmend që në vitin 1510, kronisti Gjon Muzaka. Sipas tij “...*il Signor Mosachi Comnino detto dal vulgo Dangelino, ch’ hebbe un castello che se chiamò Biesca et altri casali assai che sono in Cerminichi e Tamadia*”⁹. Në vitin 1650, një misionar i huaj, Jacinth Sospello, që kreu një udhëtim misionar në ato vende, i

⁵ A. Ducellier, “L’Arbanon et les Albanais au XI ...”, f. 367; Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, Tiranë: “Pegi”, 2006, f. 17-19.

⁶ “*sono verso i confini di Macedonia e Bulgaria altri popoli che si chiamano Paesi di Scanderbec, cioè Emathia, Benda, Corbini, Tamadea, Cermenica, posti nelle montagne sopra Croia et Elbasani*”, shih: Injac Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII*, vëll. I (1610-1634), Tiranë: 1963, f. 300. Po ai, *Dokumente të shekujve XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë*, vëll. III (1603-1621), Tiranë: 1989, f. 380.

⁷ “*Sign. Arianiti Comneno fu signor di Cerminica e de Mocheno e de Spatenia*”, G. Musachi, “Breve memoria de li discendenti de nostra casa Musachi”, në: Ch. Hopf, *Chroniques gréco-romanes inédites ou peu connues*, Berlin: 1873, f. 283, 287; Injac Zamputi, *Dokumente të shekujve XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë*, vëll. III, f. 37.

⁸ Selami Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke në shek. XV. Burime osmane*, Tiranë: 1968, f. 332.

⁹ G. Musachi, “Breve memoria ...”, f. 288. *Biesca (Pieshka)* ekziston sot si emër fisi në Gurakuq të Bizës.

përmend Bendën e Tamadhenë si dy segmente në vazhdim të itinerarit të tij, që vazhdonte më tej në thellësi, në kufijtë e Dibrës së Sipërme, nëpërmjet luginës së Sopotit, ku ndodhej edhe Vajkali i Skënderbeut (*tutta la Benda sino a Tamadeia e più dentro alli confini della Dibra superiore nella valle di Sopot passata la Valcalia di Scanderbeg*)¹⁰. Në të njëjtin kontekst, duket se e fut Tamadhenë një dokument i vitit 1669, ku, mes famullive të dioqezës së Bendës, përmenden Gedin, Bastari, Gurabardhi, Shën Martini, Shën Gjergji, *Tamazei* (Tamadhea), Valkali e Çermenika¹¹. Edhe Françesk Bolica, në relacionin e tij të vitit 1649, e përmend Tamadhenë në këtë kontekst: *Misioni i Dervenit ishte më i shtriri i të gjithëve...përfshinte në male e në rrëzat e tyre gjithë Rendesinë, Tamadhenë, Shën Martinin, Gurin e Bardhë dhe luginën e Sopotit*¹². Derveni, thotë Jacint Sospello në 1650, ndodhej 5 milje larg Krujës në drejtim të lindjes dhe në këtë krah, misioni i Dervenit, “*abbracciava tutta la Benda sino a Tamadeia, e più dentro sino alli confini della Dibra superiore nella vale di Sopot passata la Valcalia di Scanderbeg*”¹³. Kështu, në një vështrim të parë, ne na duket se Tamadheja s’mund të jetë tjetër, veç Martaneshi: ky, në drejtim të lindjes sheh pikërisht nga Dibra, siç thotë Sospello, e në drejtim të jug-lindjes sheh nga Çermenika, krahinë kjo, me të cilën Martaneshi ka afërsi të madhe, dhe jo vetëm gjeografike. Në fakt, Kadastru osman i vitit 1519, që na njoftohet nga studiuesi i njohur turk, Halil Inalçik, e shënon Tamadhenë si nahije, që bënte pjesë në vilajetin e Çermenikës¹⁴. Por në

¹⁰ I. Zamputi, *Relacione ...*, II, f. 396.

¹¹ M. Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani durante la guerra di Candia (1645-1669)*, vëll. II, Città del Vaticano: 1992, f. 718.

¹² “*La missione di Bervendi era la più vasta di tutte...comprendeva dunque nelli monti et radici d’essi tutta la Randossia, la Tamadeia, S. Martino, Pietra Bianca et valle de Sopotit*”, shih: I. Zamputi, *Relacione ...*, II, f. 376. Krahina e Randisies (Rëndisies), bënte pjesë në zotërimet e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut (G. Musachi, “Breve Memoria ...”, f. 284) dhe zgjatej në Perëndim të vargmalit Krujë-Dajt. Në vitin 1583 ishte nahije e kazasë së Akçahisarit, d.m.th. Krujës. Shih: Selami Pulaha, “Mbi gjendjen në vitet 20-30 të shek. XV në tokat shqiptare dhe mbi qëndrimin e klasës feudale kundrejt pushtimit osman”, në: *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. II, Tiranë: 1989, f. 280; Kasem Biçoku, *Për Skënderbeun*, Tiranë: 2005, f. 70-71; Kristo Frashëri, *Skënderbeu. Jeta dhe Vepra*, Tiranë: 2002, f. 69, 70.

¹³ I. Zamputi, *Relacione ...*, II, f. 396.

¹⁴ Halil Inalçik, “Les regions de Kruje et de la Dibra autour de 1467”, në: *Deuxième Conférence des Études Albanologiques*, vëll. I, Tirana: 1969, f. 236.

një regjistër më të mëvonshëm, atë të Ohrit të vitit 1583, Tamadhea përfshihet, bashkë me Bendën, në listën e sanxhaqeve¹⁵.

Bashkë me problemin e identifikimit të njësive gjeografike, del edhe problemi akoma më i vështirë i identifikimit të njësive kishtarë të Arbrit. Padyshim, Arbri gjeopolitik nuk është një me Arbrin kishtar¹⁶. Ky i fundit, fillon e shfaqet në nivelin e një peshkopate katolike aty nga fundi i shek. XII (viti 1166) dhe me një shtrirje që kapte masën kryesore të trevës së Mirditës¹⁷. Nga shek. XIV në dioqezën e Arbrit u përfshinë edhe zonat e Kurbinit, Ishmit e të vendit të dikurshëm të Jonimëve, në bregdetin Lezhë-Ishëm¹⁸. Në kuptimin kishtar, trevat e Arbrit përfshiheshin, deri në shek. XII, në disa dioqeza: në ato të Durrësit, Krujës, Stefanisë, Kunavisë e Lezhës¹⁹. Kjo ishte edhe treva ku katolicizmi dhe ortodoksia u ndeshën për një kohë të gjatë, deri sa në shek. XIV u duk se Roma triumfoi përfundimisht mbi Kostantinopojën, duke i lidhur popullsitë e tyre me variantin katoliko-roman të besimit të krishterë²⁰. Gjithsesi, ndarjet kishtarë mbeteshin një dukuri e paqëndrueshme në Shqipëri, në varësi edhe të kushteve të trazuara politike që kalonte vendi. Për rrjedhojë, edhe treva e Arbrit, me një krishtërim të hershëm e të zhvilluar, që rezistoi aty deri në kapërcim të shek. XVII-XVIII, kur edhe u islamizua përfundimisht, ka qenë ndarë në dioqeza, që në rrjedhë të shekujve kanë ndërruar emrin apo shtrirjen (juridiksionin), gjë që nuk i njëson ato me krahinat gjeografike²¹. Është

¹⁵ Selami Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare, shek. XV-XVI*, Tiranë: 1988, f. 289.

¹⁶ Aleksandër Meksi, “Peshkopata e Arbërit”, në: *Hylli i Dritës*, nr. 5-6, Tiranë: 1995, f. 40.

¹⁷ Po aty, f. 39.

¹⁸ Kasem Biçoku, “Mjedisi kishtar e politik i Kuvendit të vitit 1462”, në: *Formula e Pagëzimit*, Tiranë: 2008, f. 12-13, 19-20.

¹⁹ Milan Šufflay, “Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchszone im katholischen Damme”, in: *Illyrisch-Albanische Forschungen*, I. Band, München und Leipzig: 1916, f. 197, 203.

²⁰ Alain Ducellier, *La façade maritime de l’Albanie au Moyen âge. Durazzo et Valona du XI^e au XV^e siècle*, Tessalonike: 1981, f. 553.

²¹ Peter Bartl, *Albania Sacra: Geistliche Visitationsberichte aus Albanien*, Wiesbaden: 2007, f. 17-18; A. Meksi, “Peshkopata e Arbërit ...”, f. 39. Për të sjellë një shembull se si ndryshonin kufijtë e ipeshkvnie dora dorës që përparonte invazioni osman, kujtojmë që në vitin 1404 kuvendi benediktin i Shën Mërisë së Brretit (*Sancta Maria de Bereto*) bënte pjesë në dioqezën e Krujës. Në vitin 1421 ky kuvend kishte kaluar në varësi të dioqezës së Arbrit (*monasterii Sancte Marie de Bereto Arbanensis*).

rasti i dioqezës së Kunavisë, emri i së cilës vjen nga kohët e vjetra, por që sot nuk gjen vend në hartën e Shqipërisë. Këtë peshkopatë, që gjendej në Arbër, Shuflaj e vendos në zonën e brendshme të Matit, në pellgun ujëmbledhës të lumit me të njëjtin emër²², ndërkohë që Stadtmüller zgjedh derdhjen e poshtme të lumit, zonën e Breg-Matës²³. Nga ana e tij, A. Meksi i afrohet Shuflajt, kur i nis kufijtë e Kunavisë nga malësia e Shëngjergjit, në lindje të Tiranës²⁴. Argumenti kryesor që ka shtyrë në një vendosje të tillë të Kunavisë, duket se ka qenë pohimi i historianit bizantin të shek. XIII, Akropolit, i cili flet për një udhëtim të sforcuar të tij në mes të dimrit të vitit 1258 në itinerarin Durrës-Kunavi-Mat-Dibër²⁵. Pra, është presupozuar një udhëtim drejtvizor me nisje nga Durrësi, në një kohë kur, për rrethanat e pasigurta që mbretëronin atë kohë në traktin e rrugës Egnatia, të kontrolluar nga kështjellat e Ndroqit (Andronikut), Ishmit e Prezës, Akropolit ka të ngjarë të ketë zgjedhur unazën jugore të Egnatias, atë që nga Durrësi çonte në Rrogozhinë e Peqin, e prej këndej priste diagonal për të dalë në Petrelë e prej këndej vazhdonte drejt malësisë së Shëngjergjit e Matit. Gjithsesi, identifikimi i Kunavisë me malësinë e Tiranës, fqinje me viset e Matit, bie ndesh me gjithsa thotë për këtë çështje në relacionin e tij të vitit 1644 Arqipeshkvi i Durrësit, Mark Skurra, që për nga origjina krutane dhe detyra, ishte një njohës i shkëlqyer i gjeografisë kishtare të Arbrit. E pra, sipas Skurrës, dioqeza e Kunavisë, që ishte sufragane e Arqipeshkvisë së Durrësit, shtrihej në brezin kodrinor midis Kavajës e Lushnjës²⁶. Në fakt, thotë Skurra, në Kunavi kishte arra, vreshta e ullishte, dhe një gjë e tillë na çon sigurisht

Me sa duket, kalimi i Krujës në duart e osmanëve, në 1415, kishte bërë që famullitë e kësaj ipeshkvnje t'i bashkëngjiteshin ipeshkvnisë fqinje të Arbrit. Shih: *Monumenta Albanica*, vol. I: Registra Lateranensia annos 1401-1454 continens, nr. 62, f. 193; nr. 212, f. 486.

²² “Dunkel ist... die Entstehung des Bistums von Chunavien, einer Landschaft zwischen Durazzo und den Bergen auf der Östseite des oberen Tales des Mat; auch die Residenz dieses Bischofs mit eigenem Domkapitel (1320) ist gänzlich unbekannt”, shih: M. Šufflay, “Die Kirchenzustände ...”, f. 196.

²³ G. Stadtmüller, *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, Wiesbaden: 1966, f. 171.

²⁴ A. Meksi - D. Komata, “Kisha e Shën Mërisë së Brarit”, në: *Iliria*, Tiranë: 1987, nr. 2, f. 224.

²⁵ G. Akropolitae, *Chronike Syngraphe*, bot. Teubner, Lipsiae: 1903, f. 143.

²⁶ L. Tacchella, *Il Cattolicesimo in Albania nei sec. XVII-XVIII*, Verona: 1984, f. 65-67.

në një zonë me klimë të butë bregdetare, dhe aspak në malësitë e Shqipërisë së brendshme, nëse do të merrnim si të mirëqenë vendosjen e Kunavisë në rrjedhën e sipërme të Matit apo në malësinë e Shëngjergjit²⁷. Fakti që Mark Skurra saktëson që, Kunavia ishte afër malesh (*vicina alli monti*) nuk e komprometon vendosjen pranë bregdetit të saj, pasi në të vërtetë idenë e një mali mbisundues japin lartësitë e Krrabës e të Elbasanit në raport me peizazhin kodrinor që fillon në shpinë të vijës bregdetare Durrës-Kavajë-Lushnjë²⁸. Mbi këtë bazë, edhe Farlati e vendos Kunavinë në një “ultësirë të ëmbël” (*amoena planitie*), që fillon në këtë brez bregdetar dhe që më tej, mes malesh, i afrohet Maqedonisë²⁹. Dhe në fakt këtu e vendos këtë krahinë edhe gjeografi i lashtësisë, Straboni, i cili pohonte, se “ata që nisen nga Apollonia dhe Epidamni, pihen në një pikë të rrugës, që ka largësi të njëjtë nga këto dy qytete (është fjala për Rrogzhinën e sotme-P. Xh.). Rruga e tërë quhet Egnatia: trakti i parë i saj kalon nga Kandavia, mal i Ilirisë”³⁰. Në vitin 1662, ipeshkvi i Durrësit, Nikolla Karpeni, thotë që Kunavia quhej nga vendasit në gjuhën shqipe *Cavara*, duke na e sjellë qartazi afër emrit të qytetit të sotëm të Kavajës³¹.

Në kohën kur Mark Skurra ishte Arqipeshkv i Durrësit, rreth vitit 1640, vetë qyteti buzë Adriatikut kishte mbetur pa asnjë të krishterë (*dentro nella città non ci sono christiani*)³². Kështu, për t’i siguruar autoritetin, por edhe të ardhurat e kreut të kishës së Durrësit, që njëherësh ishte edhe kreu i peshkopatave varëse të Krujës, Bendës, Lisit, Kunavisë, Stefanisë e Albanit (Elbasanit)³³, ky mori nën administrim të

²⁷ I. Zamputi, *Relazione ...*, vëll. II, f. 342.

²⁸ *Po aty*, f. 274.

²⁹ D. Farlati, *Illyricum Sacrum*, vëll. VII, f. 408.

³⁰ Straboni, “Geographica”, libr. VII, në: *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*, Tiranë: “Toena”, 2002, f. 158. Krhs. me: A. Pertusi, *Martino Segono di Novo Brdo vescovo di Dulcigno. Vita e Opere*, Roma, 1981, f. 113. Në të njëjtin pozicion, në një trakt të rrugës nga Maqedonia (Ohri) në Durrës e Apolloni, e vendos Kandavinë edhe Jul Qezari: *Pompeius erat eo tempore in Candavia iterque ex Macedonia in hiberna Apolloniam Durrachiumque habebat* (Caes. Comment. Belli Civ., III, 11, 2); *Pompeius per Candaviam iter in Macedoniam expeditum habebat* (Ibid., III, 79, 2).

³¹ “*Il vescovado Canoviense, detto in lingua Albanese Cavara*”, shih: J. Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani durante la guerra di Candia (1645-1669)*, vëll. II, Città del Vaticano: 1992, f. 275.

³² I. Zamputi, *Relazione ...*, vëll. II, f. 226.

³³ *Po aty*, f. 252.

drejtpërdrejtë një trevë mjaft të gjerë. Kjo përmbliidhej në hapësirën që fillonte me Shijakun, vazhdonte drejt Veriut deri në Ishëm (Mollëkuqe-*Molacucci*), mandej shkonte në Lindje deri në Brar të Tiranës, ku ndodhej manastiri i famshëm i Shën Mërisë, rezidencë verore e arqipeshkvit të Durrësit (*ha santa Maria sita sopra la villa di Berrari, antichamente fu chiesa famosissima di devotione et miracoli e spasso dell'Arcivescovo di Durazzo*). Prej Brarit, vija ndiqte një drejtim jugor, deri në Elbasan, duke lënë nën juridiksionin e arqipeshkvit të Durrësit gjithë fshatrat në Perëndim të vijës Priskë-Barbas-Pllumbas-Skuterrë-Shën Gjon, prej nga ku vazhdohej në drejtimin perëndimor, drejt Bishqemit, Peqinit, Rrogozhinës, Kavajës, për të përfunduar përsëri në shpinë të Durrësit, në Shijak³⁴. Në këtë shtrirje të gjerë, Arqipeshkvia e Durrësit i kishte hequr edhe peshkopatës së Kunavisë atë që ne mendojmë se ishte bërthama e peshkopatës së hershme të Kunavisë, malësinë e përfshirë brenda kuadratit Shijak - Ndroq - Pezë - Petrelë - Krrabë - Shën Gjon - Bishqem - Peqin - Rrogozhinë - Kavajë - Shijak. Që kjo malësi, e cila shpaloset në krahun e djathtë të atij që udhëton nga Tirana drejt Elbasanit, ishte Kunavia e vërtetë, këtë na e provon edhe një dokument i vitit 1318, ku përmendet kisha e Shën Nikollës në Petrozë të Kunavisë (*ecclesie sancti Nicolai de Petrosa Cunaviensis*)³⁵. Petroza, në fakt, është edhe sot një lokalitet mes Pezës e Kavajës.

Gjithsesi, nga ajo çka kemi thënë deri tani, rezulton se identifikimi i vendeve të Arbrit paraqet vështirësi serioze: nuk mjafton njohja e dokumentacionit, duhet domosdoshmërisht edhe njohja e terrenit. Mosnjohja e këtij të fundit ka çuar në keqkuptim studiues të dalluar të historisë, politike e kishtarë të Shqipërisë. Kështu, duke mos e njohur gjeografinë e malësisë së Tiranës, Le Quien gabon kur në një dokument të Papës Bonifaci IX, të vitit 1404, ndeshet me përmendjen e dioqezës “*Priscensis et Bendensis*”, që ishte krijuar nga bashkimi i dy ipeshkvnie fqinje (*invicem canonice invictis*). Gabimisht ai e kupton “*Priscensis*” si “*Prisrenensis*”³⁶. Këtë interpretim të tij, e hedh poshtë Farlati, i cili e konsideron të pamundur që, dy peshkopata aq shumë larg njëra-tjetrës, Benda e Prizreni, të drejtoheshin nga i njëjti peshkop. Ndaj ai është i mendimit që, titulli *Priscensis* të lidhet me *Priskën* (Priska e Madhe e

³⁴ *Po aty*, f. 225-230.

³⁵ *Acta Albaniae*, I, nr. 637.

³⁶ M. Le Quien, *Oriens Christianus*, vëll. III, Paris, 1740, f. 953.

Priska e Vogël), lokalitet që është fqinj i drejtpërdrejtë i Bendës³⁷. Por këtij interpretimi logjik nuk i qëndron, një shekull pas tij, studiuesi i njohur i historisë mesjetare të Shqipërisë, M. Shuflaj. Jo fort i njohur me gjeografinë e Shqipërisë, edhe ky, si Le Quien, e ngatërron *Priscensis* me *Prisrensis*, dhe duke qënë se pas vitit 1404, titulli i peshkopatës shfaqet me binomin tjetër *Bendensis et Stephanensis*³⁸, ai konkludon se, *Priscensis* (që sipas tij shënon dioqezën e Prizrenit) dhe *Stephanensis* janë e njëjta gjë: e dyta zëvendësoi të parën në një moment të caktuar. Pra, sipas Shuflaj, dokumenti i vitit 1404 i Papës Bonifac IX, bën fjalë për një peshkopatë të Prizrenit dhe të Bendës (apo të Bendës e të Stefanisë, që zëvendësoi më vonë Prizrenin)³⁹. Ndryshe nga Eubel, që për mendimin tonë e ka drejt kur identifikon dioqezën e Priskës me atë të Stefanisë⁴⁰, Shuflaj e njëson arbitrarisht ipeshkvninë e Stefanisë me atë të Prizrenit: në fakt, i painformuar për ekzistencën e zonës së Priskës në shpatin perëndimor të vargmalit Krujë-Tiranë, ai, siç theksuam më parë, e lexon fjalën “*Priscensis*” sikur të ishte “*Prisrenensis*”⁴¹. Dhe i ndërgjegjshëm që Stefania nuk mund të ishte tepër larg nga Prizreni, për sa kohë e zëvendësoi këtë të fundit në emërtimin episkopal, e zhvendos Stefaninë sa më afër Prizrenit, në skajin veri-lindor të krahinës së Matit⁴². Në fakt, në këtë drejtim, nga Dukagjini deri në Lurë, Qidhën e Sinjë të Dibrës, Mark Skurra në 1641 përmend dioqezin e Lisit (*Lisiense*)⁴³.

³⁷ D. Farlati, *Illyricum Sacrum*, vëll. VII, f. 402.

³⁸ Kështu në 20 dhjetor 1363, përmendet “*Demetrius episcopus Stephanensis et Bendensis*”, ashtu si përmendet dioqeza dhe titullarë të ndryshëm të ipeshkvisë së Stefanisë e Bendës edhe në shek. XV apo edhe gjatë shekujve të parë të sundimit osman. Shih: *Acta Albaniae*, II, appendix 21; K. Biçoku, “Mjedisi kishtar dhe politik i Kuvendit ...”, f. 15; *Monumenta Albanica*, bot. E. Lala-M. Ahmeti, vëll. I: Registra Lateranensia annos 1401-1454 continens, nr. 161, f. 411; nr. 168, f. 414; nr. 170, f. 416. Falenderojmë Dr. Lala dhe Dr. Ahmeti, që patën mirësinë të na venë në dispozicion dorëshkrimin e veprës, që del së shpejti nga shtypi nën siglën e Shtëpisë Botuese Ombra GWG.

³⁹ *Acta Albaniae*, II, nr. 747, shën. 1.

⁴⁰ C. Eubel, *Hierarchia Catholica medii aevi*, vëll. I, Münster, 1898, f. 488.

⁴¹ *Acta Albaniae*, vëll. II, nr. 326, shën., 748, shën. 1.

⁴² Milan Šufflay, *Acta Albaniae*, vëll. I, nr. 57 (shënimet). Megjithatë, në një punim të mëvonshëm, M. Šufflay pohon se “ai nuk dinte ta përcaktonte me siguri vendndodhjen e peshkopatës së Stefanisë”, shih: M. Šufflay, “Die Kirchengestände ...”, f. 195.

⁴³ I. Zamputi, *Relacione ...*, II, f. 244-252.

Sa i përket Stefanisë, kjo sigurisht përmendet si një krahinë apo peshkopatë fqinje me krahinën apo njësinë kishtare të Bendës. Emri duhet të lidhet me kështjellën *Stephaniacum* të ndërtuar nga Perandori Justinian, në shek. VI⁴⁴. Më tej, Stefaniaka u kthye në seli peshkopale, dhe në vitin 879 gjejmë të përmendet për herë të parë Kozmai, peshkop i Stefanisë, që mori pjesë në sinodin e Kostandinopojës bashkë me eprorin e tij, Mitropolitin e Durrësit, Lucianin, me të cilin, në atë rast, iu bashkua skizmës së Fotit⁴⁵. Një tjetër peshkop i Stefanisë përmendet në vitin 1366, Pjetri. Ky, deri në atë kohë, kishte qenë peshkop i Bendës, dhe kaloi në peshkopatën fqinje të Stefanisë me urdhër të Papës Urbani V⁴⁶. Më tej, deri në shek. XVII, kemi një sërë peshkopësh të Stefanisë, mes të cilëve përmendim Gjergj Skurën, të cilin në vitin 1549, Papa Pali III e transferoi nga prifti i kishës së Shën Kollit në Durrës, në peshkop të Stefanisë⁴⁷. Për t'u përmendur janë Silvestri "*de Albania*", i caktuar në 1582 nga Papa Grigori XIII si peshkop i Stefanisë e i Bendës, dhe në fund Nikollë Mekajshi, i emëruar në 1592 nga Klementi VIII⁴⁸. Që të tre këta prelatë, me sa duket ishin me origjinë nga kjo krahinë, siç lënë të kuptohet edhe mbiemrat Sgura (Skura) e Mekajshi. Për sa i përket vendndodhjes së Stefanisë, një përshkrim i Shqipërisë i vitit 1578 na informon se peshkopata e Stefanisë ishte larg njëmijë e tetëdhjetë hapa (afro dy kilometra) nga Kruja, në drejtim të Greqisë, d.m.th. të Jugut, ku ndan nga njëra-tjetra dioqezën e Kunavisë nga ajo e Bendës⁴⁹. Siç pamë më sipër, në vitin 1404, ipeshkvnia e Bendës ishte bërë një me atë të Priskës. Por përmendja e ipeshkvnisë së Priskës përbën një rast të izoluar. Në fakt, që në vitin 1404 ajo na kumtohet për një herë të vetme si "ipeshkvi e Priskës dhe e Bendës", normalisht del me emrin "ipeshkvnia e Stefanisë dhe e Bendës"⁵⁰. Stefania, pra, na rezulton të mos jetë gjë tjetër veç Priska⁵¹. Në çdo rast, ajo shtrihej në Lindje të Krujës (*Il*

⁴⁴ Procopius, *De aedificiis*, libr. IV, kap. 6.

⁴⁵ D. Farlati, *Illyricum Sacrum*, vëll. VII, f. 405.

⁴⁶ *Po aty*.

⁴⁷ *Po aty*, f. 406.

⁴⁸ *Po aty*.

⁴⁹ *Po aty*, f. 403; *Acta Albaniae*, I, nr. 57 (shënimet).

⁵⁰ D. Farlati, *Illyricum Sacrum*, vëll. VII, f. 402; I. Zamputi, *Relacione ...*, II, f. 266, 267.

⁵¹ Ndryshe nga ne, K. Biçoku i jep një shtrirje mjaft të gjerë dioqezës së Stefanisë, nga shpina e Krujës, në kufijtë e Elbasanit e deri në Lis të Matit. Në të njëjtin

vescovo Stefanensis, che ha il vescovado sopra Chrogia in Albania)⁵². Duke pranuar si ngushtimet, ashtu edhe zgjerimet e mundshme, na rezulton se selia e hershme, ipeshkvnia e Stefanisë (Stefaniakës), njësohet pak a shumë me atë të Priskës, dhe ashtu si kjo, pas shek. XIV, ka qenë e bashkuar kishtarisht me ipeshkvninë e Bendës. Bashkime të tilla peshkopatash, që vinin sa për mungesë të klerit, aq edhe për ngushtim të hapësirës së krishterë nga avancimi i fesë islame, dëshmohet këtë kohë edhe për peshkopatat fqinje të Krujës e të Arbrit. Peshkopata e Stefanisë ishte pikërisht fqinje me Krujën (jo në Verilindje të Matit, siç hamendëson Shuflaj). Në dallim nga bashkëpeshkopata e Bendës, Stefania përmblihte fshatrat në shpatin perëndimor të vargmalit Krujë-Tiranë, nga Priska e Vogël në Priskën e Madhe, me Brarin (*Burani*), ku ndodhej manastiri i vjetër i Shën Mërisë, që dikur kishte shërbyer si rezidencë verore e Arqipeshkvit të Durrësit, kurse në vitet 1601 ishte kthyer në rezidencë e Nikollë Mekajshit, ipeshkv i Stefanisë dhe i Bendës, njëherësh Vizitator i Përgjithshëm Apostolik i Shqipërisë⁵³. Që dioqeza e Stefanisë ishte në afërsi të Krujës, këtë e provon edhe një dokument i vitit 1595, ku thuhet se, “ipeshkvi i Stefanisë e ka ipeshkvninë e tij mbi Krujë, në Arbëri”. Dhe me rastin e projektit për kryengritje anti-osmane, në vitet 1595 e 1602, pikërisht për arsye të afërsisë gjeografike, ipeshkvit të Stefanisë, Mejkashit, i ishte besuar sulmi mbi qytetin e Krujës e rrethinat e saj⁵⁴.

Gjeografinë e peshkopatave të prapashpinës së Durrësit duket se e sqaron më mirë Mark Skurra. Sipas tij, dioqeza e Krujës qëndronte në të majtë të Durrësit drejt Veriut, dioqeza e Bendës ndodhej përtej Durrësit, mes malit të Krujës e malit të Trodhenit, dioqeza e Albanit, d.m.th.

punim ai e njëson Stefaninë me Bendën e, më tej, me Lisin: K. Biçoku, “Mjedisi kishtar dhe politik i Kuvendit ...”, f. 15, 16.

⁵² I. Zamputi, *Relacione ...*, II, f. 48.

⁵³ Në 1601, ipeshkvi i Stefanisë e i Bendës, Nikollë Mejkashi, ishte vendosur pikërisht në Manastirin e Shën Mërisë së Brarit (*Burani*). Shih: I. Zamputi, *Relacione ...*, II, f. 266, 267. Për një informacion më të gjerë për manastirin në fjalë, shih: A. Meksi - D. Komata, “Kisha e Shën Mërisë së Brarit ...”, f. 215-227; A. Dhima, “Gërmime në Brar”, në: *Iliria*, Tiranë: 1987, nr. 2, f. 265; E. Soppi, “Të dhëna të reja të përftuara gjatë restaurimit të kishës së Shën Mërisë së Brarit”, në: *Culture Populaire Albanaise*, X (1990), f. 91-99.

⁵⁴ I. Zamputi, *Relacione ...*, II, f. 82, 296.

Elbasanit (*La città d'Albano...presso il fiume Scumino*)⁵⁵ kufizohet me atë të Bendës dhe shtrihet në jug të saj. Në fund, dioqeza e Kunavisë vijon pas asaj të Albanit dhe mbërrin deri në detin Adriatik, duke qëndruar në të djathtë të Durrësit, rreth 17 milje larg tij⁵⁶. Gjithashtu, Mark Skurra citon një për një fshatrat ku shtrihej juridiksioni i ipeshkvnisë së Bendës: mes të tjerëve ai përmend Shëngjergjin, Shëngjinin (*Sceginasi*), Shën Palin (Shupali), Fraveshin (*Javacessi ?*), Qafë'Mollën (*Colle di Molla*), Kemardan (*Chemarda*), Mnerin (*Mneri*), Bastarin, Gurabardhin (*Pietrabianca*), Shën Martinin, Xibrin (*Ziburi*) e Batrën (*Baderra*), etj.⁵⁷ Në kuadrin e pronave të regjistruara, Defteri osman i Dibrës i vitit 1467, shënon fshatrat e mëposhtëm, si pjesë e nahijes (vilajetit) të Bendës: Pijaç, Muniz, Kulura, Bensch, Budonish, Kutis, që të gjithë të paidentifikueshëm sot, si dhe fshatrat e njohur Bastar, Bulçesh, Dush (*Mdush*), Bruç (*Brus*) Shëngjin, Fravesh, Selitë,

⁵⁵ F. Cordignano, "Geografia ecclesiastica dell'Albania", në: *Orientalia Christiana Periodica*, vol. XXXVI, Roma: 1934, f. 35.

⁵⁶ Po aty, f. 31; "Relacion i Mark Skurrës, post 1644", në: I. Zamputi, *Relacione ...*, vëll. II (1634-1650), Tiranë, 1965, f. 320.

⁵⁷ "Relacion i Mark Skurrës, arqipeshkv i Durrësit, 20 dhjetor 1641", në: I. Zamputi, *Relacione ...*, vëll. II, f. 236-238; L. Tacchella, *Il Cattolicesimo in Albania nei secoli XVII e XVIII*, Verona: 1984, f. 64. *Pietrabianca*, që citohet këtu e në mjaft burime të tjera të kësaj kohe (Rel. Marin Bicic, 1610, në: I. Zamputi, *Relacione ...*, I, f.142) tjetër nuk është veç forma e italianizuar e *Petralba-s* latine të Barletit (M. Barleti, *Histori e Skënderbeut*, bot. II, Tiranë: 1967, f. 80, 81, 86 etj. Po ashtu në një dokument të vitit 1567: *Petra alba*, shih: Injac Zamputi, *Dokumente të shek. XVI-XVII*, vëll. I, Tiranë, 1989, f. 242). Ishte vendlindja e Pjetër Budit: *Pietra Bianca, fortezza di Cruatia in Albania della casa di antichi Budi di Macedonia* (v. 1621, letër e Pjetër Budit, në: I. Zamputi, *Relacione ...*, I, f. 196). Oliver Schmitt, në librin e tij më të ri, *Skënderbeu*, i referohet vazhdimisht *Gurabardhit* me emrin sllav *Bela Kamena*. E pra, Schmitt premton që në hyrje të librit (f. 35, shën. 73), se emrat e vendeve e të personave në librin e tij do të jepen në formën që gjenden në dokumentacionin e kohës. Forma sllave *Bela Kamen*, në dijeninë tonë, përdoret vetëm në Defterin Osman të Sanxhakut të Dibrës, 1467, e huazuar, pas çdo gjase, nga regjistra sllavë të kryepeshkopatës së Ohrit. Schmitt preferon t'i përmbahet pikërisht këtij shembulli të vetëm, që i duket se mbështet tezën e tij, pas së cilës treva e Dibrës (në këtë rast, deri në Mat!), pra, vendet nga vinin Kastriotët "ishin etnikisht të përzier" (f. 37). Vlen të thuhet, se Gurabardhi ndodhet pikërisht në qendër të enklavës së Matit, të cilën Georg Stadtmüller e ka përcaktuar si bërthamën e Shqipërisë, një zonë etnikisht e pastër, hermetikisht e mbyllur dhe e pashkelur nga ndikimet e nga kolonizimet romake apo sllave. Shih: G. Stadtmüller, *Forschungen zur abanischen Frühgeschichte*, 2. Auflage, Wiesbaden: 1966, f. 118-122.

Linzë, Shupal⁵⁸. Pra, një shtrirje e gjërë, që përfshinte zonën e Shupalit (Priskës), të Shëngjergjit (ndoshta përfshirë edhe Martaneshin) e një pjesë të Matit, me Xibrin e Gurabardhin. Peshkopata e Bendës përmendet për herë të parë në vitin 1363, me peshkop Pjetrin⁵⁹. Në kohën e pushtimit osman, Benda e humbi rëndësinë e saj. Farlati, që citon gjeografin Baudrand, pohon se “sipas Kuropalatit, Benda është një qytet i Maqedonisë në viset e Arbrit, seli peshkopale nën juridiksionin e Kryepeshkopit të Durrësit, që tani, pas pushtimit nga Turqit, është kthyer në një rrënojë; peshkopi i saj qëndron në kështjellën e Mamlit dhe gjithë krahina që shtrihet rrotull qytetit të Bendës quhet edhe ajo Bendë, ku bën pjesë edhe treva e Çermenikës në anët e Krujës, siç kemi mësuar nga Kryepeshkopi i Durrësit”⁶⁰.

Në një punim tonin, kemi bërë një përpjekje për të vërtetuar se bërthamën e Principatës së Arbrit, në shek. XII-XIII, e përbënte pikërisht krahina e Bendës. Po aty kemi hedhur tezën, sipas së cilës princërit e Arbrit, Progoni dhe bijtë e tij, Dhimitri e Gjini, i përkisnin familjes së mirënjohur Skurra, nga ajo trevë⁶¹. Në zonën e Bendës ekzistojnë ende sot dy fshatra me këtë emër, njëri në kufi me fshatin Mner, kurse tjetri akoma më thellë drejt Lindjes, ku këtë emër e mban një lagje e fshatit Shëngjin në malësinë e Shëngjergjit. Por emri Skurrë rezulton me një përhapje të gjerë në të gjithë territorin e Arbrit⁶². Sigurisht, varri monumental i *sebastit* Mihal Skurra (1201) në kishën e Shën Mërisë së Brarit, flet shumë në të mirë të statusit të lartë, social e politik të

⁵⁸ H. Inalçik, “Les régions de Kruje et de la Dibra autour de 1467”, në: *Deuxième Conférence des Études Albanologiques*, vëll. I, Tirana: 1969, f. 231; S. Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke në shek. XV. ...*, f. 346, 370-374.

⁵⁹ D. Farlati, *Illyricum Sacrum*, vëll. VII, f. 404.

⁶⁰ *Kuropalati* (κουροπαλάτης) i përmendur këtu nga Baudrandus, është padyshim kronisti bizantin i shek. XI, Joan Skylitze, i cili edhe e ka mbajtur një titull të tillë. Por, siç vëren me të drejtë Farlati, Skylitze flet për një vend me emrin *Bodina*, të njëjtin që Kedreni më vonë e quan *Bodena*, dhe që qartësisht s’ka të bëjë me Bendën tonë, por me qytetin e Vodenës në Maqedoni. Shih: D. Farlati, *Illyricum Sacrum*, vëll. VII, f. 401.

⁶¹ Në një traktat të vitit 1210 midis Republikës së Raguzës dhe zotit të Arbërit, *panhypersebastit* e *magnus archondit* Dhimitër, midis garantëve që nënshkruajnë marrëveshjen në fjalë në emër të Dhimitrit, shfaqet edhe një *Andreas Stapanus* (Andrea Shtëpani). Emri na sjell pikërisht në Shëngjergj të Bendës, ku akoma sot Shtëpanët përfaqësojnë njërin nga familjet më me emër në atë zonë. Shih: Pëllumb Xhufi, në: *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I, Tiranë: “Toena”, 2002, f. 230-231.

⁶² P. Xhufi, “Skurrajt e Arbërit”, në: *Studime historike*, 1991, nr. 2, f. 106.

Skurrajve⁶³. Në fakt, gjatë gjithë Mesjetës, emrin Skurra e mbante një ndër familjet më të shquara të Arbrit, që hyri në marrëdhënie të privilegjuara me Bizantin, me Anzhuinët apo me vetë Perandorinë Osmane⁶⁴. Ne dimë se ndonjë pinjoll i Skurrajve, përveç posteve të larta ushtarake, pati mundësinë edhe të lidhte krushqi me vetë familjen e Perandorit Bizantin. I tillë ishte *strategu* Leon Skurra, i cili në vitet 1200 ishte komandant i Korintit e i Nauplionit⁶⁵, dy kështjella që akoma dy shekuj më vonë mbroheshin nga luftëtarë (*stratitotë*) shqiptarë⁶⁶. Origjina shqiptare e Leon Skurrës tashmë është marrë si një gjë e mirëqënë nga historianët⁶⁷. Në vitin 1203, Leon Skurra u martua me Evdoqinë, vajza e Perandorit Bizantin, Aleks III Ëngjëll⁶⁸. Nga ana tjetër, një mbishkrim ktitorial (themelues) në kishën e Shën Klementit të Ohrit, i vitit 1295, na njeh me një personazh të rëndësishëm, *megas eteriarchos* Progon Skurra, që ishte atë kohë komandant i qytetit e që përmendet edhe në cilësinë e dhëndërrit (γαμβροῦ) të Perandorit të Bizantit, Andronikut II Paleolog⁶⁹. Tani, të arrije të hyje në rrethin familjar të Perandorit nëpërmjet martesave me princesha bizantine, kjo sigurisht përbënte një privilegj që jo çdo familje nga provincat shqiptare mund ta gëzonte. Skurrajt, siç duket, e kishin këtë privilegj. E nëse ne, njohim dy raste të krushqive perandorake nga ana e bujarëve shqiptarë, e këta i përkasin që të dy

⁶³ A. Meksi-D. Komata, “Kisha e Shën Mërisë e Brarit ...”, f. 215-227.

⁶⁴ Përmendim strategët e Korintit, Leon Skurra (1202), të Ohrit, Progon Skurra (1295) dhe të Janinës, *sebasti* Skurra (1321), si dhe Isa bej Skurrën (Uzkuri), bejlerbe i Anadollit në mesin e shek. XV. Shih: W. Miller, *The Latins in the Levant. A history of frankish Greece (1204-1566)*, London: 1908, f. 78; C. Jireček, *Geschichte der Serben*, Gotha: 1911, f. 338; F. Dölger, *Regesten der Kaiserurkunden des oströmischen Reiches von 565-1453*, IV. Teil, nr. 2454; S. Pulaha, *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. II, Tiranë: 1989, f. 304.

⁶⁵ Akropolites, *Chronike Syngraphe*, Lipsiae: 1903, f. 24.

⁶⁶ J. Poulos, “E epoikesis ton Albanon eis Korinthian”, në: *Eperis tou Mesaionikou Archeiou*, 3 (1950), f. 52 vj.; D. Zakythinis, *Le Despotate grec de Morée*, vëll. II, Athènes: 1953, f. 29-36; P. Topping, “Albanian Settlements in Medieval Greece: some Venetian Testimonies”, në: *Charanis Studies*, bot. A. Laiou-Thomadakis, New Jersey, 1980; C. Sathas, *Documents inédits relatifs à l'histoire de la Grèce au Moyen âge*, vëll. VI, f. 159, 175 etj.

⁶⁷ C. Sathas, *Documents inédits ...*, vëll. I, Paris: 1880, f. XXII; F. Babinger, “Albanische Stratioten im Dienste Venedigs”, në: *Studia Albanica*, 1964, nr. 2, f. 101.

⁶⁸ Akropolites, *Chronike ...*, f. 24; W. Miller, *The Latins in the Levant*, f. 78.

⁶⁹ H. Gelzer, *Der Patriarchat von Ochrida*, Leipzig: 1902, f. 13; J. Ivanova, *Bllgarski starini iz Makedonija*, Sofia: 1931, f. 38.

familjes Skurra, nuk kemi pse të mos hamendësojmë që të ishte nga kjo familje edhe dhëndërrin i tretë perandorak, princi Dhimitër i Arbrit, që siç dihet, u martua me Komnenën, mbesë e Perandorit Aleks III Ëngjell i Bizantit. Aq më shumë kur dimë se Komnena kishte lindur nga martesja e Stefan Nemanjës së Serbisë me Evdoqinë, bija e preferuar e Perandorit Aleks III. Siç pamë më sipër, kjo kaloi në një martesë të re me strategun Leon Skurra (1203), disa vjet më parë se vajza e saj, Komnena, të martohej me princin e Arbrit, Dhimitrin. Dhe nëse lidhjet e krushqisë me familjen e perandorit bizantin ishin një privilegj i rezervuar për vetëm familje të veçanta nga “provincat” bizantine, dhe në rastet e njohura familja që e gëzonte këtë privilegj në mjedisin shqiptar ishte familja e Skurrajve të Arbrit, nuk kemi pse të dyshojmë që edhe dhëndri tjetër perandorak, princi Dhimitër, t’i përkiste pikërisht familjes Skurra. Më sipër dhamë një sërë argumentesh që çojnë në këtë përfundim. Në mbyllje do të donim të kujtonim edhe një fakt të panjohur. Rreth dy shekuj e gjysëm pas princit Dhimitër, treva e Bendës në Arbër qeverisej ende nga një pinjoll i Skurrajve. Në fakt, një dokument i vitit 1469 na informon se një *Vucho Scura* ishte “*voyvode montanee Bende super Croyam*”, pra kreu i malësisë së Bendës, mbi Krujë⁷⁰. Dhe ky nuk është i vetmi personazh, që pas vdekjes së Skënderbeut, vazhdonte të mbante gjallë traditën e luftës për liri në malësitë “mbi Krujë”. Një shekull e gjysëm më vonë, në 1607, njihemi me një prijës po nga malësia mbi Krujë, Idar Maneshi, pa dyshim pasardhës i bashkëlufëtartit të ngushtë të Skënderbeut, Pal Maneshit⁷¹. Siç e thotë vetë edhe emri, Idari ishte tashmë një nga të konvertuarit e shumtë në rradhët e parisë shqiptare.

⁷⁰ Këtij *voyvodë* Vuk Skurrës, Venediku i kishte akorduar në kohën e Baldasar Perducit, një sërë privilegjesh, të cilat ju rikonfirmuan edhe në 2 qershor të vitit 1469 nga Senati i Republikës: “*Sumus contenti ut confirmes privilegia concessa per Baldassarum Perduci Vucho Scura, vayvode montanee Bende super Croyam iuxta opinionem et consilium, non excedendo summam ducatorum XII in mense*”. Shih: J. Radonić, *Djurad Kastriot Skenderbeg I Albanija u XV veku*, Beograd: 1942, f. 215.

⁷¹ M. Barleti, *Histori e Skënderbeut*, përkthyer nga latinishtja S. Prifti, bot. dytë, Tiranë: 1967, f. 167-170. Defteri i Sanxhakut Arvanit i vitit 1431, shënon disa fshatra me emrin Manes (Manesh), të shpërndarë në vilajetet e Pavlo Kurtikut e të Akçahisarit (Krujës). Kurse Regjistri Osman i vitit 1467, e përmend shpesh familjen Maneshi, të përqëndruar gjithnjë në “kurorën” malore që rrethon Krujën nga Lindja dhe nga Veriu, posaçërisht në fshatrat Pijaç e Bastar të Bendës, në Martanesh e në Kurbin. Shih: H. Inalçik, *Sûret-i Defter-i Sancak-i Arvanid*, Ankara: 1954, f. 90, 92, 96, 105, 106, 108, 111; S Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke në shek. XV ...*, f. 332, 344, 346, 370.

Por, edhe pse i islamizuar, Idar Maneshi kishte vendosur të bëhej një Skënderbe i ri (*si avea lasato dire che vol esser un altro Scanderbeg*). Për këtë qëllim ngriti flamurin e kryengritjes fillimisht në malësinë e Krujës, dhe kur sanxhakbejlerët e Ohrit e të Elbasanit erdhën me ushtri për ta shtypur atë, Idari me shokë u zhvendos në malësitë e Dukagjinit, Kthellës e Selitës, ku mundi të mbledhë menjëherë tre mijë luftëtarë të gatshëm për luftë dhe llogariste të bënte një ushtri të vërtetë prej 24 mijë vetësh⁷². Kjo kryengritje duhet të ketë lënë gjurmë të thella tek shqiptarët e kohës. Padyshim ishte një zhvillim i ri fakti që shumë shpejt pas konvertimit në islam, shqiptarë myslimanë, si Idar Maneshi, kishin rrëmbyer flamurin e kryengritjes kundër osmanëve. Ky zhvillim nuk i shpëtoi një vëzhguesi të mprehtë të zhvillimeve politike në Shqipëri, siç ishte Pjetër Bogdani. I frymëzuar nga rebelimi i bashkëpatriotëve myslimanë, në një kohë kur vala e kryengritjeve antiosmane të mbështetura nga Vatikani e Napoli po përjetonte një periudhë depresioni, Bogdani u josh ta shihte tashmë shpëtimin e vendit, jo aq tek Zoti apo tek ardhja e ndonjë ushtrie kryqtare nga Evropa, por tek ndonjë “renegat” mendjendriçuar shqiptar, që ashtu si dikur Skënderbeu, do të vihej në krye të ushtrive shqiptare e do të përzinte Turqit⁷³. A thua të ketë patur Bogdani parasysh pikërisht shembullin e Idar Maneshit, për të mbetur edhe pas tij tek shpresa e ringjalljes së një “Skënderbeu mysliman”?

⁷² “*essendo un turco per nome Idar Manesi sopra Croia, infra montagne, forse seguito di gente et si avea lasato dire che vol esser un altro Scanderbeg et il sanzacho di Orida con il sanzacho di Elbasan fatto gran campo et in provista di notte andato sopra detto Idar Manesi et malamente a scapulato la vita con la sua fameia et gli furno brusar le sue case et tutto quello aveva sotto, et detto Idar Manesi subito fece tremila valentomini soldati et andò nella provincia di Duchagini et di Chela et Selitta unidi insieme tutti et giurati esser contra il turcho che si fariamo per il numero di vinti quattro milia valentomini eletti*”, shih: J. Tomić, *Grača za istoriju pokreta na Balkanu protiv turaka krajem XVI i početkom XVII veka*, vëll. I, Beograd, 1933, f. 438.

⁷³ “Si potrebbe non dimeno, un giorno caggionar qualche gran bene a questa città quando qualche renegato studioso, et abituato in qualche bona opera, et sentimento divenisse capo d’essecciti come successe sotto Amurate in Giorgio Castriotti detto Scanderbeg”, Odette Marquet, *Pjetër Bogdani. Letra dhe dokumente*, Shkodër: “At Gjergj Fishta”, 1997, f. 84.

S u m m a r y

ARBËRIA'S BENDA IN THE LATER MIDDLE AGES

At the end of the 12th century, more evidently, but in fact since the 11th century, the byzantine sources in the beginning, followed a little later by the Papal and Slavic ones, start distinguishing a central territory of the medieval Albania, which they called Arbër. (greek. Ἀλβανον, lat. *Albanum*, slav. Рабънь). Due to its geographic position, close to Durrës and along the Egnatian Way, Arbër has been in the center of the medieval history, not only of Albania, but of the history of Adriatic – Balkans, as well. That is why famous scientists of balkanology and albanology have baptized Arbër as the “nucleus” of medieval Albania. In this territory, around the end of the 12th century, the Principality of Arbër, the first formation of an Albanian medieval government was created. During the 14th century, the land of Arbër, more or less integrated the lordship (*county*) of Topiaj, and in the 15th century it was unified with the stable center of the State of Skanderbeg. Even on 1621, one and a half century after Skanderbeg's death, a well-known habitant of these lands, Pjetër Gudi from Gurabardh, testifies that the territories once belonging to Arbër, were now called “the lands of Skanderbeg” by his compatriots. Thus were considered the cities of Mat, Benda, Kurbin, Tamadhé and Çermenikë, which are part of the highlands behind the cities of Krujë and Elbasan. This study aims to throw light on one of the regions that belonged to Arbër, Benda. In that effort, the study tries to define the geographical position of Benda, as related to neighbor territories. It begins from Tomadhé, precisely identified in Martanesh, mentioned with that name in late sources. The author presents a new concept concerning the geographical location of the lands of Kunavi and Stefani as well. This concept confronts the locations given by authors like Šufflay or Stadtmüller. On the other hand, based on the unused documents and on a reconsideration of the historic documentation, it is proved that Benda is the place of origin of the famous family Shkurra. On an earlier study, the author has mentioned the thesis that the Princes of Arbër during the 12th and 13th century, Dhimitër, Gjon, Progon belonged to this family. The fact that, even during the 16th – 18th century, Benda remains a center for the political and military development, regarding to the resistance against the ottoman occupation, is another element brought by the author.